

RIBOTIM I DYTË I PËRMIRËSUAR ANALIZË PLUS

“Dili zot Matematikës, o i mjerë, sepse ...”

Ishte prof. Dr. Hajredin Hoxha, Rektor i Universitetit të Prishtinës, i viteve 80’ të shekullit të kaluar, personi i cili hyri në “histori suksesi” lidhur me botimin e teksteve universitare te ne në Kosovë! Kush mbanë mend, ai atëbotë patë thënë: “Në Universitetin e Prishtinës nuk ka vend asnjë mësimdhënës, i cili nuk shkruan një libër apo një dispensë për studentët e tij”!

Kjo “fjali lapidare” pati ndikimin e saj pozitiv e frytdhënës, duke hapur një hulli të pasur kërkimesh shkencore, te shumica e mësimdhënësve universitarë të asaj kohe! Vërtetë ishte “periudhë e artë” e prurjeve të vazhdueshme dhe cilësore nga të gjithë lëmenjtë e diturive shkencore, ”epokë” e cila për fat të keq mori fund, me turp të madh!

Në vigjilje të botimit të parë, të këtij libri (2008),”ora e Rektoratit” të UP-së ishte ndal! Ndalohej botimi i librave universitarë nën “ombrellën”e tij, duke rrënuar medoemos një traditë sjelljeje të kulturuar shkencore katërdhjetëvjeçare! Ndodhi kjo në vitin jubilar, të 100-të nga Kongresi i Alfabetit (Drejtskrimi, 1908) dhe në agun e Pavarësisë së Kosovës! U çmeritën njerëzit e “shkrim-leximit”! Bota akademike u step, por jo e gjitha! **Dhe në vitet e mbijetesës (1990-2000), UP nuk ndaloi botimin dhe participimin e librave universitare . Rektori “antitankist”, për librin e sapobotuar ka ngre doli!**

“Metodologji e mësimdhënies së matematikës” padyshim “ajka”e gjashtë librave të mi të botuar, do jetë libri i parë i ribotuar, në mbështetje të kërkesave të studentëve dhe mësuesve. Shitja e (500) kopjeve nga botimi i parë, për rrethanat kosovare, ndodhi në afat rekord, përgjatë një viti kalendarik (mars 2008-mars 2009)! Libri është shitur në 40-të vendbanime, në gjithsej 74 shkolla, nga dy herë të vizituara, rrugëtim i padëgjuar dhe i paparë, ndonjëherë tjetër tek ne, nga një autor libri universitar! Shtegu i udhëtimit ishte jo më pak se 1500 km në vajtje dhe 1500 km të tjera në kthim. Nga koha kur në treg nuk kishin mbetur kopje të tjera, interesimi i lexuesit për LIBRI-n rritej, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni dhe Shqipëri!

Për “punën prej pionieri” që autori bëri në këtë disiplinë shkencore, si zakonisht u shfaqë prirja e jonë e mbrapshtë e injorimit të asaj që ”nuk është e imja”.Të gjithë ata matematikanë shqipëtarë, të njohur, me “frymëmarrje”, të sistemuar në Google, që u njohën, lexuan apo dëgjuan, për punën studimore tridhjetëvjeçare të autorit, preferuan të heshtin, të mos thënë asgjë publikisht, ”për të mirë” ose “për të keq”! Ky libër e meritoi vlerësimin publik me shkrim! Në botën intelektuale, artistike e shkencore, ka një konkurrencë të pashmangshme brenda llojit, por edhe jashta tij. Zakonisht, botimin e librit të kolegut, “akademiku” e konsideron si mossukses personal të tij! Qëndrimi dhe sjellja e tillë injoruese, e shfaqur nga smira, nuk i bën nder shkollës shqipe! Padyshim, në lidhje me Metodologji e mësimdhënies së matematikës, krahasuar me të tjerët përreth nesh, neve na përket një prapambetje, shumë më shumë se pesëdhjetëvjeçare ! Shih, **Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të nxënësve; në lexim, matematikë**

dhe shkencë PISA/2016; kishte radhatur Kosovën në vendin 68-të, në mesin e 72 shteteve !

Për t'ia ngre akoma më shumë cilësinë librit, kam bërë përpjekje të vazhdueshme që për “gabimet teknike” të hetuara, nga botimi i parë, të kishte ndreqje e përshtatje të tjera, në më shumë se 125 faqe libri!- Përmirësimet e nevojshme ishin nga gramatika; leksiku; morfologjia; sintaksa; drejtshkrimi; të simboleve dhe me shtesa të tjera përmbajtësore. Jo vetëm kaq, çdo kapitull shkencor është pajisur me **“portën hyrëse”**: NË HYRJE dhe me **“portën dalëse”** : NË VEND TË PËRFUNDIMIT, ku përmbledhur trajtohën, ta zëmë: Monumenti më madhor i mendimit njerëzor të antikitetit helen: Shndërrimi i matematikës në shkencë; frika e brendshme nga matematika; si të futesh në matematikë; statusi shoqëror i pazgjidhur i matematikanit; ndërtimi i kuptimit të tekstit; në cilat klasë duhet doemos organizuar mësimi ekipor; shqiptarët si mund t'a përmirësojnë sistemin e tyre të shkollimit; detyrat funksionale të mësuesit: -si **transmetues diturie** që janë të shumtë dhe -si **rojtar diturie** që mjerisht na janë rralluar; “pushteti i notës”; përse shumica prej nesh nuk janë në gjëndje ta zbatojnë “artin e leximit kritik” e shumë të tjera.

Deri në moshën 35 vjeçare isha në padijeni të plotë, për të shkruar! Krejt rastësisht vendosa të mësohem të bëhem shkruer nga hiçi, për të qenë, dhe këtë nga **“dy rreshta në ditë”**! Më mirë të shkruaj vonë se kurrë! Hyra në “pyllin e pashkelur shqiptar”, të dhuruar nga mësuesit e mi, për të mos dalë prej tij plot 40-të vjet, duke lënë pas veti “dëshmi” dhe “dëshmitarë”. Tani filli sa vjen dhe mbështillet deri në përfundimtaren, të cilën askush nuk e di! Libri ribotohet i plotësuar dhe i përmirësuar, në vitin 2020-të, në jubileun e 40-të vjetorit të punës shkencore të autorit dhe 75-të vjetorit të lindjes së tij.

Mësimdhënia paraqet veprimtarinë intelektuale “artistike” e cila kërkon trajtim të përhershëm deri në “përsosmëri”! Metodologji e mësimdhënies së matematikës merret me punë kërkimore, krijuese-zbuluese të modelit matematik, të ndeshme (ngadalë e pa u nxituar), të palodhshme dhe të pallogaritshme. Ajo ia shpërblen mundin të gjithë atyre që interesohen për atë! Megjithatë, **puna studimore i ka “ditët e numëruara”! Ajo gjithnjë ndodhet në harxhim kohe!** Aty dhe atëherë, duke qenë i mbushur me ngazëllim, nuk ndjehesh i lodhur, sepse të joshë dhe të rrëmben ambienti intelektual, për të krijuar!

Aktualisht, duke trashëguar **“librin bazik”** të kësaj mësimdhënieje, në cilësinë e **“abetares matematike”**, brezit të ri i mbetën detyra të tjera, sepse **“abetarja” nuk mund të qëndrojë e vetmuar** dhe ajo e ka synim gjithnjë, modifikimin! Por, nëse aspironi të lëni ndonjë gjurmë, lidhur me **arsimin** (shkollimin) **kompjuterik** (informativ), i **cili dita - ditës po bëhet më i rëndësishëm në përkufizimin e diturisë** dhe të shkathësive themelore të arsimit, bëni përpjekje për të qenë **“të dehur nga puna”** dhjetavjeçare! Në majat e saja të ndritura, duke paguar më parë haraçin e një mundi të madh, mund të arrijnë vetëm ata, që nuk i tremb lodhja!

*Gjakovë,
28.10.2018.*

Autori